



---

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2001/26**

**NDRYSHIMI I URDHËRESËS ADMINISTRATIVE 2001/7 PËR ZBATIMIN E  
RREGULLORES SË UNMIK-ut NR.1999/3 MBI THEMELIMIN E DOGANAVE DHE  
SHËRBIMEVE TË TJERA LIDHUR ME TO NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me nenin 6 të Rregullores së ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/3 të datës 31 gusht 1999 mbi Themelimin e doganave dhe shërbimeve të tjera lidhur me to në Kosovë dhe nenin 8.1(d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë ,

Pas shpalljes së Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2001/7 të datës 29 maj 2001 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/3 mbi Themelimin e doganave dhe shërbimeve të tjera lidhur me to në Kosovë,

Me qëllim të ndryshimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2001/7 për të lehtësuar aplikimin e ligjit të zbatueshëm doganor lidhur me përfundimin e konvertimit nga marka gjermane ("DM") në euro,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1  
Ndryshimet

Urdhëresa administrative nr. 2001/7 do të ndryshohet si vijon:

- (a) Në nenin 9.6, "25 marka gjermane (DM)" do të zëvendësohet me "12,50 euro";
- (b) Në nenin 14.2, "1,50 DM" do të zëvendësohet me "75 centë" dhe "1 DM" do të zëvendësohet me "50 centë";
- (c) Në nenin 14.4, "1 DM" do të zëvendësohet me "50 centë";
- (d) Në nenin 14.5, "200 DM" do të zëvendësohet me "100 euro" dhe
- (e) Në nenin 14.8, "1 DM" do të zëvendësohet me "50 centë".

Neni 2  
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 1 janar 2002.

Hans Haekkerup,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm